



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të
Huaja dhe Shoqërive Publike.

Nr. 350/14 Prot.

Tiranë, më 30/09/2016

V E N D I M

Nr. 127, Datë 30/09/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
SPITALIN RAJONAL FIER “MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË,
RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimi mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në “Spitalin Rajonal Fier”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më datë 31.03.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

1.Gjetje nga auditimi: Nga Spitali Rajonal Fier nuk janë zbatuar plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm me shkresën nr. 945/6 datë 12.06.2007, konkretisht: Në auditimin e mëparshëm të KLSH-së, janë lënë për zbatim 7 masa organizative, 6 masa zhdëmtimi dhe 1 masë disiplinore. Nga 7 masa organizative 2 masa janë zbatuar plotësisht, 5 masa nuk janë zbatuar, nga 6 masa zhdëmtimi, 1 masë është zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 4 masa nuk janë zbatuar, ndërsa 1 masë disiplinore është zbatuar plotësisht (*trajtuar më hollësisht në faqet 15-18 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të merren masat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 945/6, datë 12.06.2007.

Menjëherë

II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit u konstatua se veprimtaria e brendshme e institucionit bazohet në rregulloren e brendëshme të hartuar në vitin 1998, në të cilën nuk janë të implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe ndryshime të tjera ligjore. Përshkrimet e pozicioneve të punës dhe të detyrave të secilit punonjës nuk përputhen plotësisht me ato aktuale. Të gjitha këto kanë penguar kryerjen si duhet të detyrës funksionale nga stafi i institucionit.

-Nuk është marrë asnjë masë për miratimin e Rregullores së Brendshme, ku të përfshihen ndryshimet bazuar në ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”.

-Nuk është marrë asnjë masë për ngritjen e Këshillit Administrativ të Spitalit Rajonal Fier, bazuar në ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për Shërbimin Spitalorë në Republikën e Shqipërisë”, neni 12, Organet drejtuese të autoritetit spitalorë të Qarkut.

-Nuk është marrë asnjë masë për ngritjen e Komisionit Mjekësor të spitalit, bazuar në ligjin nr. 9106 datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” neni 12 “Organet Drejtuese të Autoritetit Spitalorë të Qarkut” (*trajtuar më hollësisht në faqen 18-20 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të merren masa dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë për:

-Miratimin e statutit të Spitalit Rajonal Fier.

-Hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme, ku të përfshihen ndryshimet bazuar në ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”.

-Ngritjen e Këshillit Administrativ të Spitalit Rajonal Fier, bazuar në ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalorë në Republikën e Shqipërisë”, neni 12 “Organet drejtuese të autoritetit spitalorë të Qarkut”.

-Ngritjen e Komisionit Mjekësor të spitalit, bazuar në ligjin nr. 9106 datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalorë në Republikën e Shqipërisë”, neni 12 “Organet Drejtuese të Autoritetit Spitalorë të Qarkut”.

Menjëherë e në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Spitali Rajonal Fier është i përbërë nga 4 godina të ndara si: “Poliklinika e Specialiteteve”, “Godina e Shërbimit të Urgjencës”, “Godina e Maternitetit dhe Godina e Pediatrisë”. Këto godina nuk janë të lidhura me njëra tjetrën dhe nuk kanë rrethim të jashtëm ku të bëhet ndarja e objekteve të spitalit me rrugën ose me godinat private (*trajtuar më hollësisht në faqen 18-20 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të merren masa për rrethimin e jashtëm të 4 godinave ku të bëhet ndarja e objekteve të spitalit me rrugët dhe me godinat private përreth.

Menjëherë e në vazhdimësi

III. Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

1. Gjetje nga auditimi: Nga Zyra e Financës e Spitalit Rajonal Fier, për vitet 2013, 2014 dhe 2015 janë bërë rialokime fondesh online në Degën e Thesarit Fier, për të cilat nuk kishte

shkresa zyrtare nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (F.S.D.K.SH) Tiranë (trajtuar më hollësisht në faqet 20-28 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtori i Spitalit dhe Zyra e Financës, të përmirësohet puna në drejtim të një komunikimi më të mirë midis strukturave të përfshira në sistemin spitalor, duke dhënë informacionin e nevojshëm në kohën e duhur, bashkërendim i punëve, veprim i cili do të ndihmojë në marrjen e masave të duhura për të parandaluar situata të vështira në likuidim të faturave të prapambetura.

Menjëherë e në vazhdimësi

IV. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.

1. Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve individuale, u konstatua se në të gjitha rastet mungonte inventari i dosjes, si dhe masat disiplinore nuk ishin të vendosura në dosjet individuale të punonjësve.

-Në Spitalin Rajonal Fier ka patur lëvizje të shpeshta të punonjësve. Konkretisht për vitin 2013 janë kryer 23 punësime dhe i janë ndërprerë kontratat e punës për arsye të ndryshme (dorëheqje, lirime, dalje në pension etj) 43 punonjësve. Për vitin 2014 janë kryer 38 punësime dhe i janë ndërprerë kontratat e punës për arsye të ndryshme 36 punonjësve. Për vitin 2015 janë kryer 34 punësime dhe i janë ndërprerë kontratat e punës për arsye të ndryshme 52 punonjësve. Nga këto lëvizje ka rezultuar se:

-Në një rast është punësuar punonjës, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”, ku është urdhëruar pezullimi deri në një urdhër të dytë, i procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve në institucionet shëndetësore, pa miratimin paraprak të Ministrit.

-Nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit, Spitali Rajonal Fier është paditur për 4 persona, nga të cilat tre janë në proces gjykim, ndërsa një çështje është përfunduar duke e detyruar Spitalin Rajonal Fier të paguajë vlerën **1,011,150 lekë**, vlerë e cila **përbën efekt financiar negativ** për buxhetin e shtetit.

-Spitali Rajonal Fier ka një çështje gjyqësore të hapur për një gjobe të lëshuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vlerën **60,000 lekë**.

-Në një rast janë shkëputur marrëdhëniet e punës për një infermiere me arsyetimin e dorëheqjes, por nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se akti i dorëheqjes është firmosur nga kryeinfermierja dhe shefi i shërbimit dhe jo nga personi në fjalë (duke qenë se ndodhet jashtë vendit), duke vënë në risk Spitalin Rajonal Fier në rast të dërgimit të çështjes në gjykatë (trajtuar më hollësisht në faqet 28-30 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

*-Nga Drejtorja e Spitalit Rajonal Fier të merren masa për shqyrtimin e **efektit financiar** në vlerën **1,011,150 lekë**, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, si dhe nga Sektori Juridik të merren masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqimit.*

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: -Vjetërsia e punonjësve të Spitalit Rajonal Fier, përditësohet në muajin janar të çdo vit dhe jo në momentin që punonjësi përmbush vjetërsinë sipas librezës së punës, në kundërshtim me VKM nr. 555, datë 11.08.2011 “Për pagat e punonjësve me arsim të lartë në sistemin e MSH”, i ndryshuar dhe VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, pika 7

-Pagesa e orëve shtesë për muajin Nëntor 2015, është kryer me listë-pagesat e muajit Dhjetor 2015.

-Për pozicionet e punës kaldaist, konstatohet se nga Spitali Rajonal Fier nuk respektohen dispozitat e Kodit të Punës në lidhje orarin e punës për periudhën nëntor – mars të çdo viti. Konkretisht, në kundërshtim me nenin 78, pika 4, pushimi ditor është vetëm 5 orë, nga 11 që duhet të ishte; nenin 85, pika 1, pushimi javor nuk është 24 orë pa ndërprerje; nenin 90, pika 2, kryejnë 82 orë pune në javë, nga 50 që është kufiri ligjor, si dhe pa marrë miratimin e Inspektoratit të Punës.

-Në lidhje me pagesat e kryera ndaj shoferëve të ambulancave, u konstatua se këta punojnë 5 ditë në javë, konkretisht: dy ditë punojnë 8 orë në ditë dhe paguhen për 8 orët e punës; një ditë në javë punojnë 24 orë në ditë, ndërsa paguhen sikur punojnë 3 ditë me nga 8 orë në ditë, duke mos u paguar për orët shtesë dhe orët e natës; dy ditë të tjera me 24 orë në dispozicion, pa pagesë. Veprime në kundërshtim me nenet 78, 80, 81, 83, 85, 88, 89 dhe 90, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqen 28-30 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtorja e Spitalit dhe Sektori i Financës, të merren masat që përditësimi i vjetërsisë, pagesat e punonjësve për orët shtesë, pushimet javore etj, të kryhen referuar dispozitave ligjore të Kodit të Punës.

Menjëherë e në vazhdimësi

V. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të Spitalit Rajonal Fier.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës, rezultoi se:

-Me transaksionin nr. 434, datë 07.12.2012 në vlerën 4,348,232 lekë dhe transaksionin nr. 21, datë 23.01.2013 në vlerën 4,348,100 lekë, janë paguar shpenzime gjyqësore me shoqërinë ■■■ shpk. Më datë 24.12.2010, shoqëria ■■■ shpk, i drejtohet Gjykatës të Shkallës së Parë Fier me kërkesë padi ku kërkon nga Spitali Rajonal Fier likuidimin e faturave të papaguara Qershor-Dhjetor 2007 dhe Gusht-Dhjetor 2008, në vlerën 4,202,481 lekë, si dhe dëmin e shkaktuar si pasojë e vonesës së likuidimeve, dëm i përlllogaritur me penalitet në masën e kamatës ligjore për pagesën e palikuiduar nga data e kalimit në vonesë e në vijim si dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 4,493,851 lekë. Më datë 20.04.2011 Gjykata e Shkallës të Parë Fier merr vendimin nr. 667 në favor të shoqërisë ■■■ shpk, ku vendos pranimin e padisë së palës ■■■ shpk Lushnje ndaj palës së paditur Spitalin Rajonal Fier, për shumën e mësipërme pra faturave të papaguara në vlerën 4,202,481 lekë dhe penalitete në vlerën 4,493,851 lekë. Më datë 26.06.2012, Gjykata e Apelit Vlorë merr vendimin nr. 701 ku lë në fuqi vendimin e Gjykatës të Shkallës të Parë Fier.

Pra efekti financiar negativ i shkaktuar si pasojë e vonesës së likuidimeve i përlllogaritur me penalitet në masën e kamatës ligjore për pagesën e palikuiduar nga data e kalimit në vonesë e në vijim si dhe shpenzimet gjyqësore, që janë paguar në vlerën **4,493,851 lekë**, përbën **efekt negativ financiar** për buxhetin e shtetit, për të cilën mban përgjegjësi ish Drejtori i Spitalit Rajonal Fier, në kundërshtim me kontratën e furnizimit pika “Detyrime të palëve” ku thuhet “...nëse i furnizuari vonon pagesën e mallrave detyrohet ti paguaj furnizuesit kamat vonesë 4/1000 për çdo ditë vonesë” (trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 të Raportit të Auditimit).

-Shoqëria ■■■ shpk, i drejtohet Gjykatës të Shkallës të Parë Fier me kërkesë padi ku kërkon nga Spitali Rajonal Fier likuidimin e faturave të papaguara mbasi nuk ka pasur kontratë midis palëve (sipas informacionit të shefes së financës datë 19.08.2013), për vitet 2008-2009, në vlerën 1,605,701 lekë. Më datë 09.05.2011, Gjykata e Shkallës të Parë Fier merr vendimin nr. 770 në favor të shoqërisë ■■■ shpk, ku vendos pranimin e padisë së palës ■■■ shpk, ndaj palës së paditur Drejtorja Spitalit Rajonal Fier, për shumën e mësipërme (pra faturave të papaguara) në vlerën 1,605,701 lekë dhe shpenzime gjyqësore në vlerën 61,953 lekë. Më datë 10.02.2013, Gjykata e Apelit Vlorë merr vendimin nr. 103 ku lë në fuqi vendimin e Gjykatës

të Shkallës të Parë Fier. Me autorizimin nr. 2950/1 prot., datë 13.06.2013 të Ministrit të Shëndetësisë pika 3 thuhet: “...për personat përgjegjës që nuk e kanë ndjekur procedurën e ankimit deri në Gjykatën e Lartë të merret masë disiplinore...”, e për rrjedhojë me transaksionin nr. 314, datë 20.08.2013 është paguar vlera **1,667,654 lekë**, për shoqërinë ■■■ shpk, e cila përbën **efekt negativ financiar** për buxhetin e shtetit (*trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Nga Drejtori i Spitalit dhe Zyra Juridike, të ndiqen të gjitha shkallët e gjyqësorit deri në Gjykatën e Lartë, për të gjitha proceset gjyqësore ku, është palë Spitali Rajonal Fier dhe të dalin personat përgjegjës që nuk e kanë ndjekur procedurën e ankimit deri në Gjykatën e Lartë dhe të merret masë disiplinore, si dhe të shqyrtohet efekti financiar në vlerën **6,161,505 lekë**, të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës.*

Menjëherë e në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: -Nga Dega e Planit dhe sektori përkatës, nuk janë mbajtur kartelat përkatëse për çdo mjet, ku të jenë të përshkruara të dhënat teknike të mjetit, defektet e konstatuara, shërbimet e kryera etj. Në pamundësi të pajisjes me kartela individuale për automjetet në pronësi të spitalit, grupi i auditimit nuk mund të japi një opinion në lidhje me riparimin e mjeteve, për arsye se mungon dokumentacioni që mundëson procesin e kontrollit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a (*trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 të Raportit të Auditimit*).

-Nga verifikimi i dokumentacionit të harxhimit të karburantit, për automjetet e Spitalit Rajonal Fier konstatohet se nuk janë shënuar kilometrat në nisje dhe mbërritje të destinacionit të mjetit, por vetëm kilometrat e përafërta, duke mos mundësuar një proces kontrolli efektiv mbi harxhimin e karburantit për këto mjete. Nga verifikimi i kryer konstatohen diferenca midis kilometrave të përshkruar dhe atyre të shënuar në fletë-udhëtimet përkatëse, kryesisht për shkak të mos-shënimit të saktë të kilometrave të përshkruar (*trajtuar më hollësisht në faqen 30-41 të Raportit të Auditimit*).

-Spitali Rajonal Fier ka 3 kaldaja me naftë të cilat ndizen për periudhën nëntor – mars, sipas orareve të përcaktuara nga titullari i spitalit. Por nga verifikimi i dokumentacionit mbi harxhimin e karburantit për këto kaldaja, konstatohet se orët e punës të regjistruara në librat e kaldaistëve, janë më tepër se ato të shënuara në dokumentacionin e konsumit të karburantit. Kjo për arsye se në librat e kaldaistëve nuk shënohet saktë ora e ndezjes dhe e fikjes së tyre, duke mos mundësuar një proces kontrolli efektiv mbi harxhimin e karburantit për këto kaldaja. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 35, gërma a (*trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtorja e Spitalit, Sektori i Financës dhe Sektori i Planit, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit në lidhje me konsumin e karburantit të mjeteve dhe kaldajave, si dhe hapjen e plotësimin e kartelave përkatëse për çdo mjet, duke rritur kërkesat për një sistem më të saktë monitorimi dhe kontrolli lidhur me këto shpenzime.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të bankës, rezultoi se:

A. Me transaksionin nr. 353, datë 18.09.2013 në vlerën 452,403 lekë blerje benzinë tollona 1,410 litra, nga të cilat 1,360 litra me vlerë **258,672 lekë**, tollona për të cilët ka kaluar afati i fundit i përdorimit, sasi e cila nuk mund të përdoret e për pasojë përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e Spitalit Rajonal Fier.

B. Me transaksionin nr. 150, datë 21.03.2014 në vlerën 1,328,030 lekë blerje eurodizel+benzinë 7,000 litra, nga të cilat 2,000 litra me vlerë **384,980 lekë**, tollona për të cilët ka kaluar afati i fundit i përdorimit, sasi e cila nuk mund të përdoret e për pasojë përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e shtetit (*trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

*Nga Drejtori i Spitalit Rajonal Fier të merren masa për shqyrtimin e **efektit financiar negativ** në vlerën **643,652 lekë**, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore për kthimin tollonave të benzinës në sasinë 3,360 litra, të cilëve u ka kaluar afati i përdorimit.*

Menjëherë

VI. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 01.01.2013-31.3.2016, në Spitalin Rajonal Fier, u audituan gjithsej 57 procedura tenderimi me vlerë të prokuruar në shumën 212,240,000 lekë me tvsh, nga të cilat 29 procedura prokurimi “Me negociim pa shpallje paraprake të botimit të njoftimit të kontratës” me vlerë të prokuruar në shumën 29,708,499 lekë me tvsh, e vlerë të kontratave të lidhura 29,575,763 lekë me tvsh.

Këto procedura janë realizuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi përzgjedhja e këtij lloji prokurimi, është justifikuar me nevojat emergjente për shkak të mungesës së medikamenteve, mallrave apo shërbimeve të ndryshme. Mirëpo, nevojat emergjente të këtyre mallrave dhe shërbimeve nuk janë shkaktuar për rastet e parashikuara në rregullat e prokurimit publik, por janë shkaktuar nga mos kryerja në kohë e procedurave të prokurimeve nga Autoritetit Kontraktor. Drejtori i Spitalit Rajonal Fier, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor i ka pasur të gjitha mundësitë financiare, kohore e ligjore, për të përdorur procedura prokurimi standarde në përputhje me rregullat e prokurimit publik. Emergjencat për nevoja me medikamente, materiale mjekimi dhe shërbime apo blerje të ndryshme, nuk janë shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara por nga vetë AK, i cili nuk ka marrë masat e duhura për të filluar në kohë procedurat e prokurimit në zbatim të VKM³⁵ nr. 32, datë 23.01.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i cili e lejon Titullari i AK që, *pa pasur fonde në dispozicion, me miratimin e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2014, të fillojë menjëherë procedurat normale të prokurimit deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet vetëm pasi fondet do të jenë në dispozicion.* Po kështu edhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” që ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2015 dhe ka shfuqizuar VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar lejon që: *“...me miratimin e ligjit për buxhetin, kur ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, titullari nxjerr menjëherë urdhërin e prokurimit. Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit. AK do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën menjëherë pas publikimit të njoftimit të fituesit, por në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e këtij publikimi”.* Tregohet qartë se, me miratimin e ligjit për buxhetin në muajin Dhjetor 2014, Titullari i AK duhej të fillonte procedurat e hapura ose kërkesë me propozim, kontratat e të cilave do të konkretizoheshin në fund të muajit janar ose shkurt; ndërsa nevojat gjatë muajve janar ose shkurt, për mallra, punë dhe shërbime do të mbulohen nga shtesat e kontratave të vitit të mëparshëm. Pra, kjo procedurë në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimit publik”, përdoret vetëm në raste tepër emergjente të mirë-argumentuar dhe jo kur emergjencat janë krijuar për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të vetë AK.

Titullari i AK, përveç se nuk ka filluar në kohë procedurat normale të prokurimit, nuk ka marrë edhe masat e duhura që të planifikonte në çdo vit buxhetor rezervat e medikamenteve dhe materialeve të mjekimit, shërbime apo blerje të ndryshme të domosdoshme këto për ushtrimin e aktivitetit normal të Spitalit në shërbim të shëndetit publik. Nga mungesa e

planifikimit apo e furnizimeve spontane vetëm për nevojat e rastit, janë krijuar emergjenca të mbartura nga viti në vit, duke e çuar nevojën për medikamente dhe materiale mjekimi apo shërbime dhe blerje të ndryshme në emergjenca të përhershme të cilat, siç u trajtua më sipër në kundërshtim me rregullat e prokurimit kanë diktuar përdorimin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të kontratës. Shmangia e procedurave standarde të prokurimit, me justifikimin e nevojave emergjente, krijon premisa për shmangien e konkurrencës në tregun e barnave, medikamenteve, materialeve dhe shërbimeve të ndryshme mjekësorë të operatorëve ekonomikë (trajtuar më hollësisht në faqet 41-111 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Për çdo rast, përdorimi i procedurës “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, duhet të dokumentohet dhe të argumentohet sipas përcaktimeve të bëra në nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në procedurat e prokurimit: “Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, që do të realizohen në zbatim të nenin 33 të ligjit të sipërcituar të mbahet dokumentacion për argumentimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik që do t’u dërgohet ftesa për ofertë dhe për negociimin e çmimeve të ofertës me operatorin fitues.

-Autoriteti Kontraktor në çdo procedurë prokurimi që do të realizojë, të argumentojë hartimin e kërkesave për kualifikim, përcaktimi dhe vendosja e tyre të bëhet në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet.

Menjëherë e në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: -Në disa raste nuk argumentohet mënyra e përzgjedhjes së operatorëve ekonomike të ftuar, çka përbën shkelje të nenit 33 pika 6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

-Në disa raste “Ftesat për negociim” i janë drejtuar operatorëve ekonomikë, nuk kanë konfirmimin e marrësit të ftesës për negociim, sipas Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 21 pika 2 dhe neni 22 pika 1.

-Specifikimet teknike nuk janë bërë konform standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu III, neni 23, pika 3.

-Planifikimi i nevojave është bërë pa ditur gjendjen në magazina, pa kërkesë të sektorit përkatës dhe pa asnjë indicie tjetër, në shkelje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar”, neni 4, pika 26. Në Spitalin Rajonal Fier nuk mbahen kartela individuale për çdo mjet në dispozicion të spitalit, ku të jenë të shënuara të gjitha defektet e konstatuara dhe shërbimet e kryera, në mënyrë që të mund të ndiqej dhe zbatimi i kontratave me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve”.

-Komisioni i pritjes së mallit nuk ka kryer kontrollin e mallit të sjellë nga firmat fituese të tenderit sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratë, bazuar në VKM nr. 914, datë, 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (trajtuar më hollësisht në faqet 71-72 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Autoriteti Kontraktor në çdo procedurë prokurimi që do të realizojë, të marrë masa që:

-ftesat për negociim të jenë të nënshkruara nga marrësit e ftesës dhe operatorët ekonomik të njoftohen për fituesin e tenderit, sipas LPP, nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 21 pika 2 dhe neni 22 pika 1.

-të argumentohet vendosja e çdo kriteri për kualifikim, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu VII, neni 61.

-të merren masa që specifikimet teknike të bëhen konform standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu III, neni 23, pika 3.

- të argumentohet përlllogaritja e fondit limit, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, neni 59.
- të bëhet planifikimi i nevojave nga sektorët përkatës të institucionit, bazuar në ligjin nr. 10 296, datë 08.7.2010, “Për menaxhimin financiar” neni 4, pika 26.
- të argumentohet mënyra e përzgjedhjes së operatorëve ekonomike të ftuar, sipas nenit 33, pika 6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- të respektohet pasqyrimi i të dhënave nga DST, sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu VII, neni 61.

Menjëherë e në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: -Spitali Rajonal Fier nuk ka përcaktuar qartë nevojat e tij, në zhvillimin e procedurës së prokurimit “Mirëmbajtja e pajisjes mjekësore skaner deri më 30.06.2014”, për arsye se kjo procedurë është zhvilluar për mirëmbajtjen e pajisjes mjekësore “CT Skaner”, ndërkohë që kjo pajisje nuk ka funksionuar pas datës 01.03.2014. Kjo ka qenë dhe arsye që operatori ekonomik i ftuar për këtë procedurë, nuk është paraqitur në datën e zhvillimit të tenderit.

-Studimi i vlerës së kontratës për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtja e pajisjes mjekësore skaner deri më 30.06.2014”, nuk është i saktë, pasi në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur vetëm në ofertën e dhënë nga OE ■■■ shpk, duke mos krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II, pika 2/ç.

-Në dy raste, nga Titullari i AK nuk është pezulluar procedura e prokurimi pas ankesës së paraqitur, si dhe nuk është ngritur grupi i punës për shqyrtimin e ankesës, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IX, pika 1.

-Në një rast, konstatohet se procedura e hapjes së ofertave është zgjatuar me 8 (tetë) ditë kalendarike, pa u argumentuar zgjatja e procedurës dhe pa informuar operatorët pjesëmarrës për datën e re të hapjes së ofertave, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IX, pika 1, gërma dh.

-Në një rast, KVO ka skualifikuar një operator ekonomik, për një kërkesë që nuk ishte parashikuar në dokumentet e tenderit.

-Në një rast, nuk ka urdhër prokurimi për procedurën e re, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, pika 1, gërma c.

-Në tre raste, nuk janë analizuar shkaqet e anulimit të procedurës së parë, përpara nisjes së procedurës së re, si dhe janë përdorur të njëjtat DST, pa i shqyrtuar ato, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VII, pika 1, gërma b.

-Në dy raste, mungon formulari i njoftimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 2, gërma a.

-Në shtatë raste, në shtesat e kontratave nuk konstatohet sektori që ka kërkuar shërbimin, ku të ishte e identifikuar nevoja e kryerjes së kësaj procedure, si dhe për këto shtesa kontrate mungon publikimi në Buletinin e APP, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4 dhe neni 38, pika 3 dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

-Në një rast titullari i AK ka urdhëruar pezullimin e procedurës dhe ka ngarkuar Njësinë e Prokurimi për shqyrtimin e ankesës së paraqitur për DT të hartuara nga e njëjta njësi, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, kreu IX, pika 1, gërma d.

-Në tre raste, KVO nuk ka në përbërjen e saj specialistë të fushës (inxhinierë mekanikë), në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu V, pika 2, gërma ç.

-Në 1 rast mungon raporti përmbledhës i miratuar nga TAK, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, pika 4, gërma h.

-Në një rast formulari i njoftimit të fituesit në rrugë elektronike, është dërguar nëntë ditë pas marrjes së vendimit nga KVO dhe jo ditën e nesërme të punës, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 58, pika 2.

-Në procedurat e zhvilluara me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve” për periudhën objekt auditimi, çdo vit janë kryer thujtë të njëjtat shërbime, si dhe këto kontrata janë realizuar në masën 100%. Nëse krahasohen kilometrat e përshkruara nga automjetet e Spitalit (varion nga 5,000 km deri në 45,000 km të përshkruara), kjo masë e shërbimeve të kryera ndaj një automjeti, nuk justifikohet për të gjithë mjetet (*trajtuar më hollësisht në faqet 41-111 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Për rritjen e efijencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike:

Autoriteti Kontraktor, duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Nga titullari i AK t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisioni i vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të tyre, pasi në disa raste nuk janë korrekte.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e anuluar, nga Autoriteti Kontraktor të analizohen shkaqet dhe të nxirren përgjegjësitë, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullat e prokurimit publik”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

Menjëherë e në vazhdimësi

VII. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël.

1. Gjetje nga auditimi. Spitali Rajonal Fier nuk ka hartuar dhe dërguar në APP, regjistër realizimi dhe parashikimi për procedurat e blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu I, pik 3/b dhe neni 4, i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 4.

-Blerjet me vlera të vogla janë kryer pa u hartuar më parë kërkesat vjetore për mallra nga sektorët e Spitalit Rajonal Fier, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik” dhe pa u argumentuar nevoja për blerjen e mallrave, materialeve dhe shërbimeve dhe konfirmimin nga magazina, në kundërshtim me kreu II, neni 8 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Në disa raste, për të njëjtën grup artikujsh apo natyrë të njëjtë malli, shërbim apo pune, janë realizuar 2 (dy) dhe më shumë procedura të ndara veçmas duke bërë kështu që vlera totale e fondit limit të copëtohet në shumë pjesë, duke shmangur përdorimin e procedurave elektronike, në kundërshtim me kreun 2, pika 1, gërma c, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007, “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar me kreun II, neni 8, pika 4, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik”.

-Në disa raste janë realizuar praktika të blerjeve me vlera të vogla për raste emergjente, nëpërmjet procedurave prokurimi manuale (me procedurë shkresore) duke eliminuar procedurat nëpërmjet platformës elektronike të APP, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë

10.01.2007, Kreu VI, pika 2, gërma ç, “Prokurime me vlera të vogla”, i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 40, “Prokurime me vlera të vogla”.

-Nuk protokollohen dhe nuk arkivohen dosjet e blerjeve të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

-Komisioni i blerjeve të vogla gjatë vitit 2015, ka bërë anulimin e procedurës së tenderit gjatë fazës së vlerësimit të OE pa asnjë shkak dhe ka hedhur në sistem po të njëjtën procedurë prokurimi, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 neni 40, pika 5 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” (trajtuar më hollësisht në faqet 111-121 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë: Nga Spitali Rajonal Fier të merren masa që:

-Të dërgohet në APP regjistri i parashikimeve të blerjeve me vlera të vogla, bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik”, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 4.

-Për të njëjtin grup artikujsh apo natyrë të njëjtë malli, shërbim apo pune, të realizohet një procedurë, me qëllim shmangien e përdorimit të procedurave elektronike në kundërshtim me kreun II, neni 8, pika 4, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në çdo fillim viti të hartohen kërkesat vjetore për mallra dhe shërbime nga sektorët e Spitalit Rajonal Fier, bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimit Publik”.

-Të protokollohen dhe arkivohen dosjet për blerjet e vogla, sipas kreut II të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Menjëherë

VIII. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për ambientet e dhëna me qira, rezultoi se me mbarimin e afatit të kontratave fillestare, Spitali Rajonal Fier ka lejuar qiramarrësit të përdorin ambientet e dhëna me qira, pa nënshkruar më parë kontratë të re qiraje si dhe pa arkëtuar detyrimet e qirasë, në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 801-825, VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore”.

Shpenzimet e energjisë elektrike dhe të ujit, janë llogaritur duke u hamendësuar për arsye se nga Spitali Rajonal Fier nuk janë marrë masa për pajisjen të këtyre ambienteve me matës për energjinë elektrike dhe ujin (trajtuar më hollësisht në faqet 121-124 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit, Sektori i Financës dhe Sektori Juridik, të merren masat që për ambientet e dhëna me qira, pas miratimit paraprak të Ministrit të Shëndetësisë, të lidhen kontratat përkatëse dhe të pajisen me matës të energjisë elektrike, ujit, si dhe të ndiqet arkëtimi në kohë i këtyre detyrimeve.

Menjëherë

IX. Auditim mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Spitalin Rajonal Fier ka funksionuar në nivele të ulëta, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin është kuptuar pjesërisht dhe ka funksionuar vetëm në disa hallka të njësisë dhe për pasojë, drejtuesi nuk ka mundur të bëjë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, pasi:

Nga Spitali Rajonal Fier, nuk është hartuar dhe dërguar në Ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm; rregullorja e brendshme nuk është e përshtatur me kërkesat e ligjit të MFK; nuk ka miratuar gjurmët e komunikimit; nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK^{-së}; nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara; njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre; njësia nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).

Gjithashtu, njësia nuk ka të përcaktuar koordinatorin e riskut, nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut; nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave, etj.

-Spitali Rajonal Fier nuk ka bashkëpunuar me FSDKSH, për përfundimin e instalimit të programit “Administrimi dhe Monitorimi i Shpenzimeve Spitalore” (trajtuar më hollësisht në faqet 124-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Spitali Rajonal Fier të marrë masat e duhura, që në të ardhmen të plotësojë dhe të dërgojë tek nëpunësi autorizues në ministri, deklaratën dhe raportin vjetor mbi cilësinë dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin e mëparshëm buxhetor për njësinë publike që mbulon, si dhe pyetësorin e vetëvlerësimit. Të hartojë dhe miratojë Kodin Etik, rregullore apo udhëzim për zbatimin e etikës, me qëllim që i gjithë stafi të udhëhiqet nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave, si dhe të hartojë një procedurë me qëllim raportimin e shkeljeve të legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

-Spitali Rajonal Fier, të marrë masat e duhura për të miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

-Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, Spitali Rajonal Fier të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

-Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, Spitali Rajonal Fier, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimin spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë, të hartojë programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, punonjësit të trajnohen dhe për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ka funksionuar dobët në këtë njësi. Gjithashtu, të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve.

-Spitali Rajonal Fier të marrë masa, në bashkëpunim me FSDKSH, për përfundimin e instalimit të programit “Administrimi dhe Monitorimi i Shpenzimeve Spitalore”, nëpërmjet të cilit do të menaxhoheshin pothuajse të gjitha aktivitetet e spitalit, si farmacia, magazinat, blerjet dhe shpenzimet, shërbimi spitalor, etj., që do të bënte të mundur jo vetëm nxjerrjen në kohë dhe të saktë të dhënave, por edhe monitorimin e të gjithë shërbimeve të spitalit, si ato mjekësore dhe ato financiare, pasi deri në momentin e përfundimit të këtij auditimi ky sistem konsiston vetëm në instalimin e një posti në sektorin e financës dhe të disa trajnimeve të punonjësve.

Menjëherë e në vazhdimësi

X. Të ndryshme

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e realizuar, me objekt: “Asgjësimin e medikamenteve, materialeve mjekësore, kite e reagent etj”, Spitali Rajonal Fier ka lidhur kontratat me operatorin ■■■ shpk në tre raste.

A-Kontrata nr. 1447 prot., datë 05.11.2012 të nënshkruar nga ana e operatorit ekonomik ■■■ shpk dhe titullarit të AK znj. ■■■, operatori ekonomik në fjalë ka marrë përsipër asgjësimin e materialeve të mjekimit dhe medikamenteve të skaduara, të akumuluar në vite. Asgjësimi do të bëhet nga shoqëria e specializuar në këtë fushë e cila do të marrë në dorëzim mbetjet farmaceutike. Vlera e kësaj kontrate është 395,000 lekë pa tvsh për asgjësimin e 2310 kg, mbetje farmaceutike.

B-Kontrata nr. 332 prot., datë 05.11.2012 të nënshkruar nga ana e operatorit ekonomik ■■■ shpk dhe titullarit të AK znj. ■■■, operatori ekonomik në fjalë ka marrë përsipër asgjësimin e materialeve të mjekimit dhe medikamenteve të skaduara, të akumuluar në vite (sipas listës bashkangjitur). Asgjësimi do të bëhet nga shoqëria e specializuar në këtë fushë e cila do të marrë në dorëzim mbetjet farmaceutike. Vlera e kësaj kontrate është 160,000 lekë pa tvsh për asgjësimin e 320 kg, mbetje farmaceutike.

C-Kontrata nr. 522 prot., datë 19.02.2014 të nënshkruar nga ana e operatorit ekonomik ■■■ shpk dhe titullarit të AK ■■■, operatori ekonomik në fjalë ka marrë përsipër asgjësimin e materialeve të mjekimit dhe medikamenteve të skaduara, të akumuluar në vite (sipas listës bashkangjitur). Asgjësimi do të bëhet nga shoqëria e specializuar në këtë fushë e cila do të marrë në dorëzim mbetjet farmaceutike. Vlera e kësaj kontrate është 55,000 lekë pa tvsh për asgjësimin e 110 kg, mbetje farmaceutike.

Vlera ekonomike totale e medikamenteve, materialeve mjekësore, kite e reagent, të asgjësuar është 6,090,356 lekë pa tvsh. U konstatuan ato medikamente që kanë skaduar për arsyes të mos-planifikimit, rakordimit të furnizimit me gjendjen në magazinë që mund të ishin përdorur n.q.s do të ishte treguar në lartësinë e duhur stafi i Drejtorisë të Spitalit Rajonal Fier.

Nga auditimi i gjendjes të secilit medikament në kohën e furnizimit, konsumin mujor, afatin e skadencës dhe prokurimin/blerjen e kryer shuma e vlerave të medikamenteve, materialeve mjekësore, kite e reagent, të asgjësuar nga fundi i vitit 2012 deri në Marsin e vitin 2016 në Spitalin Rajonal Fier si rezultat i mos-planifikimit është **4,863,388** lekë pa tvsh (pa përfshirë vlerën ekonomike të prokurimit për asgjësimin e tyre).

Shuma prej **4,863,388** lekë pa tvsh është **efekti financiar negativ**, që ka ardhur si rezultat i mosplanifikimit të saktë të sasisë së medikamenteve e kite&reagent, materiale mjekimi etj nga personat përgjegjës në Spitalin Rajonal Fier (*trajtuar më hollësisht në faqet 128-137 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë: Spitali Rajonal Fier të marrë masat e duhura, që në të ardhmen për përllogaritjen e sasisë që do të prokurohet për medikamente, kite & reagonte e materiale mjekësore, të marrë në konsideratë gjendjen e medikamenteve në kohën e prokurimit, konsumin e viteve paraardhëse, kohën e prodhimit e afatet kohore të skadencës dhe trendin që ka “malli” që do të prokurohet, në mënyrë që të minimizohet sasia e materialeve që rrezikohet të eliminohet si rezultat i planifikimit të pasaktë, që për periudhën e audituar u konstatua efekt financiar negativ 4,863,388 lekë.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në Spitalin Rajonal Fier prokurimet me të ardhura nga të ardhurat dytësore nuk ishin paraqitur në Regjistrat e Parashikimeve dhe Realizimeve të Prokurimeve Publike për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 (planifikimi). Janë përgatitur dhe hartuar regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve, vetëm për prokurimet e parashikuara e të realizuara me të ardhura nga buxheti i shtetit, duke i përfshirë të ardhurat dytësore, donacionet etj, në kundërshtim me, pikën 4, neni 12, i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të shkronjës “b”e “d”, pika 5, kreu I, i VKM nr. 1,

datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 128-137 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë: Titullari i AK të marrë masat që në të ardhmen Njësia e Prokurimit Publik të hartojë dhe të dërgojë në APP regjistrin e parashikimeve të prokurimit të fondeve publike, në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, për gjithë të ardhurat, në përputhje me formën dhe mënyrën, që parashikohet në udhëzimet e APP-së. Brenda afateve ligjore, titullari i autoritetit kontraktor të dërgojë, pas miratimit, një kopje të regjistrin të parashikimeve e realizimeve të prokurimit në institucionin qendror. Në rastet kur autoriteti kontraktor mund të ketë ndryshime në fondet që ka në dispozicion, të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike. Të dërgojë në APP^{së} ndryshimet e bëra që botohen, në formë elektronike, në Websiteⁱⁿ e APP^{së}”.

Për sa i takon raportimit të realizimeve të prokurimit publik, AK, brenda afateve kohore të dorëzojë në organet qendrore, që vënë në dispozicion fondet, një informacion të hollësishëm për veprimtaritë e realizuara të prokurimit. Institucion dërgojë APP^{së} një raport të prokurimeve të realizuara. Ky raport të tregojë edhe fondet shtesë, të krijuara apo transferuara, nga autoriteti kontraktor.

Në vazhdimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Me transaksionin nr. 472, datë 13.12.2013 në vlerën 14,602,419 lekë, për likuidim shërbimi i dializës për muajin Nëntor 2013, nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr. 1650, datë 10.12.2013, të firmosur nga ish-Drejtori i Spitalit Rajonal Fier, janë gjetur dy pacientë, të cilët janë në listën e pacientëve që marrin shërbimin e dializës, por në fakt këtë shërbim e kryenin në ■■■ Durrës. Vlera për të dy pacientët përlllogaritët në shumën 384,696 lekë, shumë e cila është mbajtur në muajin pasardhës për subjektin ■■■ sh.a Tiranë. Duke e llogaritur për 10 muajt e vitit 2013, gjë për të cilën theksojmë se shërbimi i dializës për këta dy pacientë është kryer në ■■■ Durrës dhe është paguar nga Spitali Rajonal Fier, në vlerën **3,846,960 lekë**, e cila përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e Spitalit Rajonal Fier, në kundërshtim me kontratën nr. 940 prot, datë 21.07.2010 “Për dhënien e Shërbimit të dializës renale kronike” neni 2, pika 2 ku thotë “...pagesa do të kryhet për çdo muaj, pas dhënies së shërbimit, sipas kalendarit të referimit të pacientëve dhe akt rakordimeve të kryera nga ■■■ (■■■ sh.a.Tiranë) dhe të konfirmuara nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier...”.

Për sa i përket periudhës së vitit 2012, ka ndodhur i njëjti fenomen, që për të dy pacientët, shërbimi i dializës është kryer në ■■■ Durrës dhe është paguar nga Spitali Rajonal Fier, e cila shkon në vlerën **4,616,352 lekë** dhe 6/mujori i II-të i vitit 2011, vetëm një pacient, shkon në vlerën **1,154,088 lekë**, vlera të cilat përbëjnë **dëm ekonomik** për buxhetin e Spitalit Rajonal Fier (trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar operatorit ekonomik ■■■ (■■■ sh.a.Tiranë), shpërblimin e dëmit në vlerën **9,617,400 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Pas përfundimit të shërbimeve të kryer për riparimin e skanerit, është lidhur kontrata për shërbimin e mirëmbajtjes së skanerit nr. 2701, datë 14.10.2014, me vlerë 4,620,000 lekë me tvsh, me afat 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Kjo kontratë ka hyrë në fuqi me nënshkrimin e saj (neni 18 “Hyrja në fuqi”). Por hyrja në fuqi e kontratës nr. 2701, datë 14.10.2014, me nënshkrimin e saj ka sjellë mbivendosjen e këtij shërbimi. Konkretisht, në kontratën e riparimit nr. 2668, datë 10.10.2014, neni 6 me objekt “Riparim i pajisjes mjekësore skaner”, parashikohet se garancia e kësaj kontrate është 1 vit nga lidhja e saj, pra për periudhën Tetor 2014 – Tetor 2015, shërbimet e kryera për “CT Skaner” janë të

përfshira në garancinë e kësaj kontrate, e për pasojë Spitali Rajonal Fier nuk duhej të lidhte kontratën e mirëmbajtjes (nr. 2701, datë 14.10.2014). Për pasojë pjesa e periudhës Tetor 2014 –Tetor 2015, e kontratës nr. 2701, datë 14.10.2014, **në vlerën 2,310,000 lekë** (4,620,000 lekë / 2) **përbën dëm ekonomik** për llogari të buxhetit të shtetit, për arsye se ky shërbim mbulohet nga garancia e kontratës nr. 2668, datë 10.10.2014 (*trajtuar më hollësisht në faqet 71-72 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 2,310,000 lekë nga operatori ekonomik ■■■ shpk.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në tenderin “Blerje medikamente”, viti 2014, me fond limit në vlerën 7,111,992 lekë, shpallur fitues operatorët ekonomik: 1. ■■■ për lotin 32, me vlerë të kontratës pa tvsh 798,840 lekë, 2. ■■■ e për lotet 9,14,36,73 dhe 84, me vlerë të kontratës pa tvsh 1,738,500 lekë. 3. ■■■ shpk për lotet 1,3,4,5,dhe 13. Oferta totale për lotet 2,967,200 lekë pa tvsh. Autoriteti kontraktor, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, pasi nuk ekzistonin rrethanat e caktuar për përdorimin e procedurës “Me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”. Është përllogaritur më tepër fondi limit duke rritur në mënyrë të paargumentuar çmimet për 5 medikamente/lote.

Përzgjedhja e llojit të procedurës dhe çmimet referuese të medikamenteve kanë rritur padrejtësisht vlerën e kontratës në shumën 1,294,890 lekë pa tvsh. Shuma prej **1,294,890 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik** për llogari të buxhetit të shtetit (*trajtuar më hollësisht në faqet 86-88 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 1,294,890 lekë, nga ■■■, ■■■ dhe ■■■ anëtarë të Njesisë së Prokurimit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në tenderin “Blerje kite & reagente dhe materiale”, viti 2013, me fond limit pa tvsh në vlerë 2,083,000 lekë, shpallur fitues operatori ekonomik ■■■ shpk me vlerë të kontratës me tvsh 2,499,120 lekë. Autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik pasi nuk ekzistojnë rrethanat e caktuar për përdorimin e procedurës së prokurimit: “Me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, janë rritur fiktivisht çmimet e kite&reagente e materialeve në përllogaritjen e fondit limit.

Përzgjedhja e llojit të procedurës, çmimet referuese të kite&reagente dhe materialeve kanë shtuar padrejtësisht vlerën e kontratës në shumën me tvsh **912,640 lekë** pa tvsh. Shuma me tvsh prej **912,640 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të buxhetit të shtetit (*trajtuar më hollësisht në faqet 45-46 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 912,640 lekë pa tvsh, nga ■■■, ■■■ dhe ■■■ anëtarë të Njesisë së Prokurimit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në punimet realizuara në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. 2250 prot., datë 15.8.2014, ndërmjet autoritetit kontraktor, Spitali Rajonal Fier dhe kontraktorit, bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomik ■■■ shpk & ■■■ shpk. Vlera e kontratës së lidhur me BOE është 8,171,448 lekë me tvsh,. Afati i realizimit të punimeve është 3 (tre) muaj.

a-Autoritetit Kontraktor mbas afatit së përfundimit të punimeve, (të cilat duhet të përfundonin më datë 18.11.2014, njoftimi për përfundimin e punimeve 5 ditë më parë) nuk ka vepruar në përputhje me pikën 8, Kapitulli V të kontratës: “...për çdo ditë vonese tej afatit të punimeve. Kontraktori është i detyruar t'i paguaj investitorit, gjobë në masën 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”.

Deri më datë 26.11.2014 nuk ka njoftim për përfundimin e punimeve të kontratës bazë, pra afati i përfundimit të punimeve ka vonesë minimalisht 14 ditë (25% x 8,171,448 lekë = 2,042,862 x 4/1000 x 14 = 114,440 lekë). 114,440 lekë me tvsh është penalteti që duhej të paguante BOE ■■■ shpk & ■■■. Shuma **114,440 lekë me tvsh është e ardhur e munguar me pasojë dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit.

b-Nga nënshkrimi i shtesës së kontratës nr. 3087, në kundërshtim të hapur me legjislacionin në fuqi, janë përfituar padrejtësisht nga bashkimit i përkohshëm i operatorëve ■■■ & ■■■ shpk, 900,432 lekë me tvsh.

Shuma **900,432 lekë me tvsh**, përfituar padrejtësisht nga bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë ■■■ & ■■■ shpk, **përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit (trajtuar më hollësisht në faqet 107-111 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 1,014,872 lekë nga bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë ■■■ shpk & ■■■ shpk.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: KVO^{ja} në vlerësimin e saj në procedurën e zhvilluar me objekt “Administrim i mbetjeve spitalore”, viti 2015, nuk ka marrë parasysh shpjegimet e dhëna nga OE ■■■ shpk, duke u mjaftuar me faktin që ky operator ka dërguar përgjigje me shkresë zyrtare dhe jo në rrugë elektronike. Për pasojë diferenca midis ofertës së paraqitur nga OE ■■■ shpk dhe ofertës së shpallur fitues ■■■ shpk, **në vlerën 835,200 lekë përbën dëm ekonomik** për llogari të buxhetit të shtetit. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 1, 2, 46, 53, 55, si dhe nenin 22 “Format e komunikimit” (trajtuar më hollësisht në faqet 95-97 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 835,200 lekë, nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave ■■■, ■■■ dhe ■■■.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të oksigjenit të Spitalit Rajonal Fier”, viti 2015 me procedurë “Kërkesë për propozim”, me fond limit 3,692,040 lekë me tvsh e vlerë të kontratës 3,692,040 lekë me tvsh, është rritur fondi limit **në vlerën 615,340 lekë** si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH^{së} së pajisjeve/aparatura në preventivin e punimeve, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit (trajtuar më hollësisht në faqet 104-107 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 615,340 lekë nga ■■■, ■■■, ■■■ dhe ■■■.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për ambientet e dhëna me qira, rezultoi se nga mosndjekja e zbatimit të kontratës së qirasë nr. 525, datë 21.03.2013, lidhur me personin fizik ■■■ (ambient 30 m²), buxhetit të shtetit i është shkaktuar

dëmi ekonomik në vlerën 131,400 lekë, i cili përbën detyrimin e papaguar të qirasë (*trajtuar më hollësisht në faqet 121-124 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën 131,400 lekë nga Personi Fizik [REDACTED].

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Komisioni i Blerjeve të Vogla, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 111,168 lekë**, si më poshtë:

A. “Blerje dyer druri” për vitin 2013, sepse ka skualifikuar OE [REDACTED] shpk dhe [REDACTED] shpk me qëllim parazgjedhjen e operatorit ekonomik [REDACTED] shpk. Nga këto veprime apo mosveprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit **dëm ekonomik në vlerën 79,968 lekë**, respektivisht: Për këtë procedurë kanë paraqitur ofertë OE si më poshtë: 1. [REDACTED] me vlerë 399.840 lekë pa tvsh, 2. [REDACTED] me vlerë 333.200 lekë, 3. [REDACTED] me vlerë 394.400 lekë. Komisioni i blerjeve të vogla ka skualifikuar: [REDACTED] dhe [REDACTED] shpk me argumentimin se: “Në ofertën ekonomike të paraqitur nuk jeni shprehur qartë dhe saktë në lidhje me specifikimet teknike dhe afatin kohor të kërkuar duke qenë se Riparimi i Urgjencës në Spitalin Rajonal Fier është detyrë urgjente”. Nga verifikimi i sistemit elektronik u konstatua se [REDACTED] dhe [REDACTED] shpk janë shprehur qartë dhe saktë në lidhje me specifikimet teknike por nuk është shprehur për afatin kohor, gjë në të cilën nuk është shprehur as firma fituese.

B. “Blerje Numra Identifikimi” viti 2013, sepse ka skualifikuar OE [REDACTED] pa asnjë shkak me qëllim parazgjedhjen e OE [REDACTED]. Nga këto veprime apo mosveprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit **dëm ekonomik në vlerën 31,200 lekë**, respektivisht: Për këtë procedurë kanë paraqitur ofertë OE si më poshtë: 1. [REDACTED] me vlerë 240.000 lekë pa tvsh. 2. [REDACTED] me vlerë 266.000 lekë. 3. [REDACTED] me vlerë 304.800 lekë. Komisioni i blerjeve ka skualifikuar [REDACTED] pa asnjë shkak, kjo e verifikuar dhe në sistemin elektronik të APP^{së} (*trajtuar më hollësisht në faqen 113 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar personave përgjegjës (anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla për vitin 2013: [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED]), shpërblimin e dëmit në vlerën 111,168 lekë, sipas gjetjeve të mësipërme dhe të arkëtohen në sektorin e financës të Spitalit Rajonal Fier.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Komisioni i Blerjeve të Vogla, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 75,640 lekë**, si më poshtë:

a. “Blerje Ilaçe” viti 2014, sepse janë prokuruar gjatë procedurës së tenderit me çmime të ndryshme nga çmimet reference të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Nga këto veprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit **dëm ekonomik në vlerën 46,872 lekë**, respektivisht: OE [REDACTED] shpk, ka përfituar më tepër 3,246 lekë. OE [REDACTED], ka përfituar më tepër 3,870 lekë. OE [REDACTED] shpk ka përfituar më tepër 29,512 lekë. OE [REDACTED] shpk, ka përfituar më tepër 10,244 lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet 115-116 të Raportit të Auditimit*).

b. “Blerje Ilaçe” viti 2015, sepse janë prokuruar gjatë procedurës së tenderit me çmime më të larta nga çmimet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Nga këto veprime apo mosveprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit **dëm ekonomik në vlerën 28,768 lekë**, respektivisht: OE [REDACTED] shpk ka përfituar më tepër 25,759 lekë e OE [REDACTED] shpk ka përfituar më tepër 3,009 lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet 118-119 të Raportit të Auditimit*).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar personave përgjegjës (anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla për vitin

2014-2015: ■■■ dhe ■■■), shpërblimin e dëmit në vlerën 75,640 lekë, sipas gjetjeve të mësipërme dhe të arkëtohen në sektorin e financës të Spitalit Rajonal Fier.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: me transaksionin nr. 768, datë 17.12.2015 në vlerën 205,188 lekë, paguar kamatëvonesa për ■■■ nga të cilat vlera 156,352 lekë është fatura e energjisë elektrike për muajin Qershor 2015 dhe diferenca prej **48,836 lekë** kamatëvonesa përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit (trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **48,836 lekë**, nga përgjegjësja e Sektorit të Financës ■■■.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Me transaksionin nr. 756, datë 14.12.2015 në vlerën 19,720 lekë, pagesë interneti për muajin Nëntor 2015, operatorit ekonomik ■■■ paguar dy herë vlera **19,720 lekë**, e për pasojë përbën **dëm ekonomik** për buxhetin shtetit (trajtuar më hollësisht në faqet 30-41 të Raportit të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **19,720 lekë**, nga përgjegjësja e Sektorit të Financës ■■■.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Bazuar në nenet 37, 141 e 153 të “Kodit të Punës” miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 62, si dhe kontratave individuale të punës, pika 7, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Fier, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore: “Zgjidhje të kontratës së punësimit” ose “Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate”, për personat:

1. ■■■, Specialiste Kimiste, në cilësinë e Anëtarit të NjPP, për arsye se:

a. Mosparaqitja në regjistrin e parashikimit dhe në regjistrin e realizimeve i të gjitha prokurimeve të realizuara nga të ardhurat dytësore, në kundërshtim me, pikën 4, neni 12, i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të shkronjës “b”e “d”, pika 5, kreu I, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

b. Mungon argumentimi i kritereve të vendosura në DT me objekt: “Blerje Kite Reagent dhe Materialet Konsumi për Laboratorin”, viti 2013. Në kapacitetet teknike janë vendosur kritere që nuk janë të nevojshme për realizimin e blerjes të parashikuara në këtë procedurë, janë diskriminuese dhe kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurë në kundërshtim me: nenin 2, pika 1, nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9463, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Anulimi i procedurës është kryer pas vendimit të KPP.

c. Mungon argumentimi i kritereve të vendosura në DT me objekt: “Blerje Kite Reagent dhe Materialet Konsumi për Laboratorin”, zhvilluar më datë 27.05.2013. Në kapacitetet teknike janë rivendosur kritere që nuk janë të nevojshme për realizimin e blerjes të parashikuara në këtë procedurë, janë diskriminuese dhe kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në procedurë në kundërshtim me: nenin 2, pika 1, nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9463, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Anulimi i procedurës është kryer nga vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik. Është vepruar në kundërshtim me vendimin nr. 830, datë 23.05.2013 të Komisionit të Prokurimit Publik, vendimet e të cilit sipas nenit 19/1 pika 2 e ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, janë administrativisht përfundimtare.

2. ■■■, me detyrë Shef i Burimeve Njerëzore në cilësinë e anëtarit të KVO^{së},

a. Në tenderin “Administrim i mbetjeve spitalore”, viti 2015, me urdhër prokurimi nr. 638 prot., datë 16.02.2015, me fond limit pa tvsh në vlerën 7,200,000 lekë, nuk ka marrë parasysht shpjegimet e dhëna nga OE ■■■ shpk, duke u mjaftuar me faktin që ky operator ka dërguar përgjigje me shkresë zyrtare dhe jo në rrugë elektronike. Për pasojë diferenca midis ofertës së paraqitur nga OE ■■■ shpk dhe ofertës së shpallur fitues ■■■ shpk, përbën dëm ekonomik prej 835,200 lekë.

3. ■■■, me detyrë Shefe Finance, për arsye se:

-Me transaksionin nr. 768, datë 17.12.2015 në vlerën 205,188 lekë, janë paguar kamatëvonesa për ■■■ nga të cilat vlera 156,352 lekë është fatura e energjisë elektrike për muajin Qershor 2015 dhe diferenca prej 48,836 lekë kamatëvonesa përbën dëm ekonomik për buxhetin e Spitalit Rajonal Fier.

-Me transaksionin nr. 756, datë 14.12.2015 në vlerën 19,720 lekë, pagesë interneti për muajin Nëntor 2015, firmës ■■■ paguar dy herë vlera 19,720 lekë, e për pasojë përbën dëm ekonomik për buxhetin e Spitalit Rajonal Fier.

3.1. në cilësinë e anëtares të KVO^{së}, për arsye se:

a. Në tenderin “Administrim i mbetjeve spitalore”, viti 2015, me urdhër prokurimi nr. 638 prot., datë 16.02.2015, me fond limit pa tvsh në vlerën 7,200,000 lekë, nuk ka marrë parasysht shpjegimet e dhëna nga OE ■■■ shpk, duke u mjaftuar me faktin që ky operator ka dërguar përgjigje me shkresë zyrtare dhe jo në rrugë elektronike. Për pasojë diferenca midis ofertës së paraqitur nga OE ■■■ shpk dhe ofertës së shpallur fitues ■■■ shpk, përbën dëm ekonomik prej 835,200 lekë.

b. Në tenderin me objekt: “Blerje Kite Reagent dhe Materialet Konsumi për Laboratorin”.(procedurë e datës 07.06.2013) Ka vepruar në kundërshtim me nenin 25, të ligjit 9643, datë 26.11.2006 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, pasi është përdorur informacion konfidencial i operatorit ekonomik ■■■ shpk (nga OE konkurrent) shkarkuar nga sistemi elektronik i APP^{së} hedhur për këtë procedurë, ku akses kanë anëtarët e KVO^{së}.

3.2. Anëtare e Komisionit të Blerjeve me Vlerë të vogël për arsye se:

1. Komisioni i Blerjeve të Vogla, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik:

a. “Blerje dyer druri” për vitin 2013, sepse ka skualifikuar padrejtësisht dy operatorë me qëllim parazgjedhjen e operatorit ekonomik ■■■ shpk. Nga ky veprime apo i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 79,968 lekë.

b. “Blerje Numra Identifikimi” viti 2013, sepse ka skualifikuar pa asnjë shkak një operator ekonomik. Nga këto veprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 31,200 lekë.

2. Komisioni i Blerjeve të Vogla, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik:

a. “Blerje Ilaçe” viti 2014, sepse janë prokuruar gjatë procedurës së tenderit me çmime të ndryshme nga çmimet reference të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Nga këto veprime apo mosveprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 46,872 lekë. **b.** “Blerje Ilaçe” viti 2015, sepse janë prokuruar gjatë procedurës së tenderit me çmime më të larta nga çmimet e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Nga këto veprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 28,768 lekë.

4. ■■■, me detyrë Përgjegjëse Hotelerie në cilësinë e anëtares të NjPP, për arsye se:

a. Mosparaqitja në regjistrin e parashikimit dhe në regjistrin e realizimeve i të gjitha prokurimeve të realizuara nga të ardhurat dytësore, në kundërshtim me, pikën 4, neni 12, i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të shkronjës “b” e “d”, pika 5, kreu I, i VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

b. Në tenderin “Blerje Medikamente”, me urdhër prokurimi nr. 905 prot., datë 26.03.2014, me fond limit pa tvsh në vlerën 7,111,992 lekë, ka përlogaritur më tepër fondi limit duke rritur paargumentuar çmimet për 5 medikamente/lote, me pasojë dëmin ekonomik prej **1,294,890 lekë**.

c. Në tenderin “Rikonstruksion i rrjetit të oksigjenit të Spitalit Rajonal Fier”, me urdhrin e prokurimi nr. 987 prot., datë 01.04 2015, me fond limit e vlerë të kontratës me tvsh në vlerën 3,692,040 lekë (diferenca nga fondi limit). Si rezultat i përfshirjes së TVSH^{-së} së pajisjeve/aparatura në fondin përlogaritjen e fondit limit, është rritur padrejtësisht vlera e kontratës, lidhur me OE ■■■ me pasojë dëmin ekonomik prej **1,006,390 lekë**.

5. ■■■ në cilësinë e anëtares të KVO^{-së}, për arsye se:

a. Në procedurën me objekt: “Blerje Kite dhe Reagent për Laboratorët Spitalor”, viti 2015 pas depozitimit të formularit të ankesës së operatorit ekonomik ■■■ Shpk, ka vepruar në kundërshtim të hapur me nenin 63 “*Të drejtat e personit të interesuar*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Pasi nuk e pezulluar procedurën e prokurimit, nuk e ka shqyrtuar ankesën dhe nuk ka nxjerrë vendim brenda afatit 7 ditor.

Në kualifikimin e ■■■ shpk, është vepruar në kundërshtim me pikën 3 të nenit 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe paragrafin e parë të pikës 3, neni 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

6.1. Anëtare e Komisionit të Blerjeve të Vogla, për arsye se: ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik në procedurën:

a. “Blerje ilaçe” për vitin 2014, sepse gjatë procedurës së tenderit ka prokuruar me çmime më të larta nga çmimet reference të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Nga këto veprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 46,872 lekë.

b. Blerje ilaçe” për vitin 2015, sepse gjatë procedurës së tenderit ka prokuruar me çmime më të larta nga çmimet reference të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Nga këto veprime i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 28,768 lekë.

6. ■■■, me detyrë **zv/Drejtor Teknik** në cilësinë e nënshkruarit të situacionit të punimeve, në tenderin “Rikonstruksion i rrjetit të oksigjenit të Spitalit Rajonal Fier”, me urdhrin e prokurimi nr. 987 prot., datë 01.04 2015, me fond limit e vlerë të kontratës me tvsh në vlerën 3,692,040 lekë (diferenca nga fondi limit). Si rezultat i përfshirjes së TVSH^{-së} së pajisjeve/aparatura në preventivin e punimeve, është rritur padrejtësisht vlera e kontratës, lidhur me OE ■■■ me pasojë dëmin ekonomik prej **615,340 lekë**.

7. ■■■, me detyrë Juriste, në cilësinë e anëtarit të NJPP, për arsye se:

Në tenderin “Rikonstruksion i rrjetit të oksigjenit të Spitalit Rajonal Fier”, me urdhrin e prokurimi nr. 987 prot., datë 01.04 2015, me fond limit e vlerë të kontratës me tvsh në vlerën 3,692,040 lekë (diferenca nga fondi limit). Si rezultat i përfshirjes së TVSH^{-së} së pajisjeve/aparatura në fondin përlogaritjen e fondit limit, është rritur padrejtësisht vlera e kontratës, lidhur me OE ■■■ me pasojë dëmin ekonomik prej **615,340 lekë**.

Shënim: Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të auditimit janë konstatuar përgjegjësi për personat:

1. ■■■, me detyrë ish-Drejtor i SRF, në cilësinë e titullarit të AK,
2. ■■■, me detyrë ish-Drejtor i SRF, në cilësinë e titullarit të AK,
3. ■■■, me detyrë ish-Drejtor i SRF, në cilësinë e titullarit të AK,
4. ■■■, me detyrë ish-Drejtor i SRF, në cilësinë e titullarit të AK,
5. ■■■, me detyrë ish-zv/Drejtor Teknik në cilësinë e anëtares të KVO^{-s}
6. ■■■, ish-Juristit i NjPP dhe ish-Anëtar i Komisionit të Blerjeve të Vogla,
7. ■■■, me detyrë ish-Përgjegjëse Hotelerie në cilësinë e anëtares të NjPP,
8. ■■■, me detyrë ish-zv/Drejtor Ekonomik në cilësinë e anëtares të KVO^{-së},
9. ■■■, në cilësinë e ish-anëtarit të NjPP,
10. ■■■, në cilësinë e ish-anëtarit të NjPP,

që aktualisht nuk janë në marrëdhënie pune me Spitalin Rajonal Fier, për të cilët nuk rekomandojmë masë disiplinore duke e konsideruar të ezauruar, për arsye se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja, Shoqërive Publike dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R